



Planuar / Ditezuar Punë/çm/Profdata Received/Deliverty	10. 01 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtopa Faqeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPAMSHICK	44/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.976/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtare, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.976/2021 të datës 01.12.2021 të parashtruar nga ankuesit të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati me adresë Prishtinë, kundër Vendimit Nr.31/45 të datës 24.11.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.976/2021 e datës 01.12.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.31/45 i datës 24.11.2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi, Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me datë 01.12.2021, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5733/2021 të regjistruar me numër A.nr.976/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.31/45 të datës 24.11.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është shfuqizuar Vendimi Nr.07/67 i datës 26.02.2021 për vazhdimin e mandatit të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Zyra e Kryeministrit, dhe Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë), ndërsa me datë 07.12.2021 ka dërguar kërkesën të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Këshilli, me datë 08.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Zyra e Kryeministrit, ndërsa me datë 10.12.2021 ka pranuar përgjigjen nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa e parashtruar nga ankuesi është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, administroj këto prova: Ankesën me numër protokolli 5733/2021 të regjistruar me numër A.nr.976/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.31/45 të datës 24.11.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.07/67 të datës 26.02.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kërkesën e datës 22.01.2021 për vazhdimin e mandatit Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, të dërguar nga Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për Kryeministrin dhe Ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.04/37 të datës 23.03.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të datës 10.01.2019, 15.01.2020, 30.12.2020, për ankuesin; Shkresën nga TEB Bankë; Autorizimin e datës 26.11.2021; Letërnjoftimin e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë, të datës 02.12.2021; Përgjigjen në ankesë, të datës 08.12.2021; Vendimin Nr.06/192 të datës 25.06.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.03/2017 të datës 10.07.2017 të Këshillit për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues; Përgjigjen në ankesë të datës 10.12.2021 nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Emailin e datës 07.12.2021 nga A.B për A.D; Emailin e datës 06.12.2021 nga Sh.L për A.B; Emailin e datës 13.09.2021 nga T.M për R.H; Emailin e datës 13.09.2021 nga R.H për T.M; Emailin e datës 09.09.2021 nga T.M për R.H; Emailin e datës 03.09.2021 nga R.H për Xh.S.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas administrimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa A.nr.976/2021 e datës 01.12.2021 e parashtruar nga ankuesi është e pabazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se ankuesi me Vendimin Nr.06/192 të datës 25.06.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 25.06.2014 është emëruar në pozitën e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, me mandat tre (3) vjeçar. Ndërsa përmes Vendimit Nr.04/37 të datës 23.03.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesit i është vazhduar mandati si Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut edhe për tri (3) vite tjera, gjegjësisht deri me datë 22.03.2021.

Emërimi i ankuesit në pozitën e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, në vitin 2014, dhe me pas vazhdimi i mandatit në vitin 2018 është bërë mbi bazën e dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, duke u bazuar në Formularin e vlerësimit vjetor të rezultateve në punë, të ankuesit, për vitin 2018, 2019 dhe 2020, me datë 22.01.2021 përmes shkresës me numër protokoll 328, të datës 22.01.2021 ka kërkuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme që t'i vazhdohet mandati Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, edhe për një mandat prej katër (4) vitesh. Propozimi për rend të ditës për mbledhje të Qeverisë është dërguar me datë 25.02.2021 nga Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më datë 26 shkurt 2021, ka nxjerr Vendimin me Nr.07/67 përmes të cilit ankuesit i është vazhduar mandati edhe për katër (4) vite si Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut.

Disa muaj me vonë, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 24.11.2021 ka nxjerr Vendimin me Nr.31/45, dhe ka shfuqizuar Vendimin Nr.07/67 të datës 26.02.2021 përmes të cilit ankuesit i ishte vazhduar mandati si Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut, me arsyetimin se ankuesi ka qenë duke shërbyer në mandatin e tij të dytë në këtë pozitë dhe se vazhdimi i mandatit të tretë në pozitë të njëjtë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitat e Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me Nr.31/45 i datës 24.11.2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, për faktin se i njëjti pretendon se vazhdimi i mandatit të tij është bërë pas kërkesës se udhëheqësit të drejtpërdrejtë dhe duke u bazuar në vlerësimet vjetore të rezultateve të punës siç përcaktohet me nenin 42 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Me tutje ankuesit pretendon se mandati të cilin ka qenë duke ushtruar sipas Vendimit Nr.04/37 të datës 23.03.2018 ka vazhduar edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht deri me datë 22.03.2021, andaj pretendon se ky është mandati i tij i parë në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Bazuar në këto pretendime ankimore, ankuesi kërkon të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të anulohet Vendimi me Nr.31/45 i datës 24.11.2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të mbetet në fuqi Vendimi me Nr.07/67 i datës 26.02.2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, për vazhdimin e mandatit të ankuesit si Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut. Po ashtu i njëjti kërkon që të obligohet organi i punësimit, gjegjësisht Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që t'ia kompensojë ankuesit pagën e plotë dhe të gjitha benificionet që i rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës në mënyrë retroaktive, nga data 24.11.2021 deri në kthimin e të njëjtit në punë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qellim të shqyrtimit të ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit iu referua Aktgjyqimit në rastin Nr.KO203/19 me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe rrjedhimisht konstatoi se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020, dhe i njëjti, me dispozitat e neni 32 paragrafi 3 ka

përcaktuar, se: *Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji*, ndërsa me nenin 85 ka shfuqizuar Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Po ashtu, duke u bazuar në nenin 9 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 dhe nenin 22 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe nenin 2 paragrafin 3, dhe nenin 33 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji konstatoi se pozita e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, hynë në kategorinë e pozitive të nivelit të lartë drejtues në kuadër të Shërbimit Civil, andaj, si rrjedhojë marrëdhënia e punës e ankuesit rregullohet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe ka konstatuar se me nenin 83 paragrafi 6 të këtij ligji, nëpunësve civil të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore të cilët janë emëruar sipas procedurës së Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë, ju garantohet e drejta e ushtrimit të mandatit për kohën e mbetur të përcaktuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës. Andaj, duke marr parasysh se ankuesi në ankesën e tij deklaroi se e ka ushtruar mandatin e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, deri me datë 22.03.2021, ashtu siç ka qenë e përcaktuar në Vendimin Nr.04/37 të datës 23.03.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kolegji konstaton se ankuesit nuk i është cenuar e drejta nga marrëdhënia e punës e përcaktuar me nenin 83 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ndërsa, duke iu referuar nenit 83 paragrafi 8, ndërlidhur me nenin 42 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji vlerëson se një nëpunësi civil të kategorisë së lartë drejtuese, i emëruar sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L149), i cili është duke ushtruar mandatin e parë, mund t'i ri zgjatet mandati, për të njëjtën pozitë pune, vetëm një herë. Mirëpo, meqenëse është konstatuar me lartë se ankuesi me Vendimin Nr.04/37 të datës 23.03.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka qenë duke ushtruar mandatin e dytë në pozitën e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se Vendimi me Nr.07/67 i datës 26.02.2021 për vazhdimin e mandatit të tretë si Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut, për ankuesin, është nxjerr në kundërshtim me nenin 83 paragrafi 8 ndërlidhur me nenin 42 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Andaj, duke marr parasysh konstatim se Vendimi me Nr.07/67 i datës 26.02.2021 për vazhdimin e mandatit të tretë, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, gjegjësisht dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji konstaton se Qeveria e Republikës së Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.31/45 të datës 24.11.2021, për shfuqizimin e të njëjtit ka vepruar në pajtim me nenin 55 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.



Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.976/2021

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, avokatit
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Ministrit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;